



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

RREGULLORE

**“MBI
KRITERET DHE PROCEDURËN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË
PROKURORIT”**

**KREU 1
HYRJE**

**Neni 1
Qëllimi**

Rregullorja ka si qëllim të krijojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për të siguruar rregulla të njëjta për prokurorët, duke garantuar parimin e barazisë dhe të proporcionalitetit në rastin e zbatimit të procedurës së transferimit të përkohshëm.

**Neni 2
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i parimeve, kriterëve dhe procedurave për transferimin e përkohshëm të prokurorëve në pozicione të lira të përkohshme të krijuara në sistemin e prokurorisë, në zbatim të nenin 44 dhe nenit 46 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Neni 3
Subjektet**

Subjekte të kësaj Rregulloreje janë magjistratët që ushtrojnë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit në Republikën e Shqipërisë të cilëve nuk u është kufizuar ushtrimi i funksionit për shkaqe të parashikuara në ligj.

**Neni 4
Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuara në

Ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj Rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Prokuroria në nevojë” nënkupton prokurorinë në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cënon funksionimin normal të saj.
- b) “Pozicion i lirë i përkohshëm” nënkupton rastin kur prokurori që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.
- c) “Pëlqim” është çdo shfaqje vullneti e materializuar e subjektit të kësaj Rregullore, ku identifikohet pranimi i tij për transferimin e përkohshëm në një prokurori të caktuar.
- ç) “Transferim në një pozicion të lirë të përkohshëm” është lëvizje e përkohshme e prokurorit për një periudhë të caktuar kohe, nga një pozicion i përhershëm në prokurorinë nga vjen në një pozicion të lirë të përkohshëm në një prokurori tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të lartë nëse plotëson kriteret për atë pozicion.
- d) “Mungesa e prokurorëve të disponueshëm në skemën e delegimit” nënkupton rastin kur në skemën e delegimit nuk ka prokurorë të caktuar apo kur prokurorët e caktuar janë në pamundësi ligjore për ushtrimin e funksionit.
- dh) “Prokuroria me ngarkesë më të ulët” nënkupton zyrën prokurororët e së cilës kanë ngarkesën më të ulët referuar të dhënave zyrtare më të fundit të Prokurorit të Përgjithshëm.
- e) “Prokuroria nga vjen” nënkupton prokurorinë ku prokurori është caktuar në detyrë në mënyrë të përhershme.
- ë) “Prokurori me përvojën më të pakët në atë prokurori” nënkupton prokurorin e prokurorisë nga ku do të bëhet transferimi, i cili ka përvojën më të pakët si prokuror në të njëjtën shkallë prokurorie”.

Neni 5

Parimet dhe kriteret e transferimit të përkohshëm të prokurorit

1. Transferimi i përkohshëm i prokurorit kryhet vetëm kur nevojat e prokurorisë nuk mund të plotësohet nëpërmjet skemës së delegimit.
2. Transferimi i përkohshëm i prokurorit kryhet vetëm atëherë kur në prokurorinë në të cilën do të transferohet ka të paktën një pozicion të lirë të përkohshëm.
3. Transferimi i përkohshëm i prokurorit nuk kryhet nëse efekti negativ që shkakton në prokurorinë nga vjen, çmohet nga Këshilli se, është më i madh se dobia që ai pritet të sjellë në prokurorinë ku do të transferohet. Për këtë qëllim Këshilli në çdo rast merr paraprakisht

mendimin e Drejtuesit të prokurorisë ku prokurori është i caktuar në mënyrë të përhershme.

4. Transferimi i përkohshëm, si rregull, bëhet ndërmjet prokurorëve nga prokuroria me ngarkesë më të ulët, duke filluar ndërmjet prokurorive më të afërta apo ato brenda të njëjtit juridiksion apeli me prokurorinë në nevojë. Përzjashtimisht, nëse transferimi i përkohshëm sipas këtij rregulli do të cenonte funksionalitetin e prokurorive me ngarkesë më të ulët, transferimi mund të bëhet nga prokurorët e prokurorive të tjera me ngarkesë më të ulët sipas rradhës, por në çdo rast duke respektuar parimin sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Në rast se ka më shumë se një prokuror që jep pëlqimin për transferim të përkohshëm në një prokurori konkrete, Këshilli vendos të përzgjedhë kandidatin duke marrë në konsideratë përvojën profesionale të prokurorëve dhe çështjet konkrete mbi të cilat është duke punuar.

6. Në caktimin e periudhës së transferimit të përkohshëm, Këshilli mban parasysh mbarëvajtjen e sistemit të prokurorisë në tërësi si dhe prokuroritë ndërmjet të cilave ndodh transferimi në veçanti. Në çdo rast, periudha e transferimit në kuptim të kësaj Rregullore nuk mund të zgjasë më shumë se 1 (një) vit.

7. Transferimi i përkohshëm kryhet me pëlqimin e prokurorit që transferohet. Në rastin kur asnjë prokuror nuk jep pëlqimin, transferimi i përkohshëm mund të bëhet edhe pa pëlqim, sipas kritereve të nenit 46/2 të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

8. Në përfundim të periudhës së transferimit të përkohshëm prokurori rikthehet në pozicionin e mëparshëm.

9. Transferimi i përkohshëm nuk bëhet në rastet kur prokurori është nën efektet e një mase disiplinore.

KREU II TRANSFERIMI ME PELQIM

Neni 6

Njoftimi i vendeve të lira për transferim të përkohshëm

1. Kur një prokurori është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka prokuror të disponueshëm, me kërkesë të prokurorisë në nevojë ose kryesisht, kur vlerësohet se nevoja e prokurorisë ekziston dhe plotësimi i saj mund të bëhet vetëm përmes transferimit të përkohshëm, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli njofton vendin e lirë të përkohshëm për transferim të përkohshëm ndërmjet prokurorëve që plotësojnë kriteret sipas nenit 5 dhe u bën thirrje prokurorëve për të dhënë pëlqimin.

2. Këshilli u komunikon zyrtarisht prokurorëve që plotësojnë kriteret thirrjen për dhënien e pëlqimit të cilët duhet të shprehen brënda 3 (tre) ditëve nga marrja e njoftimit.

3. Nëse nevoja e një prokurorie, në të cilën ka të transferuar përkohësisht me pëlqim një

prokuror, mund të përmbushet sërish vetëm përmes transferimit të përkohshëm, fton fillimisht, për të dhënë pëlqimin atë prokuror që është i transferuar, nëse transferimi i tij nuk cënon funksionalitetin e prokurorisë ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme.

4. Këshilli konsideron edhe marrjen e masave të tjera të parashikuara nga legjislacioni, për adresimin e nevojës në prokurorinë në të cilën synohet transferimi.

5. Transferimi me pëlqim bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:

- a) Prokurori ose prokurorët që japin pëlqimin fillimisht duhet të jenë nga prokuroria me ngarkesën mesatare më të ulët për prokuror, të asaj shkalle për të cilën kërkohet transferimi;
- b) Prokurori duhet të përmbushë kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht,

Neni 7

Kërkimi i pëlqimit nga prokurori

1. Në rastin e krijimit të një pozicioni të lirë në një prokurori, në të cilën ka prokurorë të transferuar përkohësisht me pëlqim, dhënia e pëlqimit i kërkohet fillimisht këtij prokurori.

2. Në çdo rast tjetër të krijimit të një pozicioni të lirë në një prokurori në nevojë, dhënia e pëlqimit iu kërkohet të gjithë prokurorëve që përmbushin kriteret për pozicionin e lirë të përkohshëm të shpallur.

Neni 8

Verifikimi paraprak i plotësimit të kriterëve

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikon paraprakisht plotësimin e kriterëve të prokurorit që ka dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm.

Neni 9

Shqyrtimi i dhënies së pëlqimit për transferim të përkohshëm

1. Në vlerësimin e rasteve për transferim të përkohshëm, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës krahas verifikimit të plotësimit të kriterëve të transferimit nga ana e prokurorit që ka dhënë pëlqimin, vlerëson informacionet më të fundit të përgatitura nga Prokurori i Përgjithshëm lidhur me statistikën e ngarkesës së punës së prokurorëve si dhe mendimin e Drejtuesit të prokurorisë ku ushtron funksionet prokurori në fjalë, lidhur me ngarkesën në punë të prokurorit si dhe me cënimin e funksionalitetit të prokurorisë.

2. Me kërkesë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Drejtuesi i prokurorisë dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të prokurorit. Mendimi i Drejtuesit shpreh vlerësimin e tij mbi ngarkesën e prokurorisë në tërësi dhe të prokurorit në veçanti, numrin total të prokurorëve që ushtrjnë funksionet në atë prokurori, seksionin nga i cili

vjen prokurori, pasojat që mund të ketë në ngarkesën e prokurorisë transferimi i prokurorit, si dhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën prokurori mund të transferohet përkohësisht duke mbajtur në konsideratë efektet më të ulëta negative që mund të vijnë nga transferimi. Mendimi i Drejtuesit të Prokurorisë nuk është përcaktues.

3. Në përfundim të shqyrtimit të rasteve të cilët kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm, bazuar në ndikimin e transferimit, në ngarkesën e prokurorit që ka dhënë pëlqimin, si dhe në përvojën profesionale të tij, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një raport për çdo rast dhe ia paraqet Këshillit për shqyrtim dhe vendim duke i propozuar miratimin e transferimit të përkohshëm.

Neni 10

Vendimmarrja e Këshillit

1. Këshilli merr vendim për të transferuar përkohësisht prokurorin që ka dhënë pëlqimin pas shqyrtimit dhe propozimit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Vendimi i komunikohet menjëherë prokurorit dhe Drejtuesve të Prokurorive.
2. Këshilli mund të vendosë që efektet e vendimit të transferimit të përkohshëm të prokurorit të fillojnë në një kohë më të mëvonshme nga data e vendimit.

KREU III

TRANSFERIMI PA PELQIM

Neni 11

Fillimi i procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim

Kur nevojat e një prokurorie për prokurorë nuk mund të plotësohen nga skema e delegimit dhe as nga transferimi i përkohshëm me pëlqim i ndonjë prokurori, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës njofton Këshillin i cili vendos për nisjen e procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim të një prokurori.

Neni 12

Kushtet dhe kriteret e veçanta të transferimit pa pëlqim të prokurorit

1. Kur asnjë prokuror nuk jep pëlqimin për t'u transferuar përkohësisht në një prokurori, transferimi pa pëlqim bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:
 - a) Prokurori ose Prokurorët duhet të jenë nga Prokuroria me ngarkesën mesatare më të ulët për prokuror, të asaj shkalle për të cilën kërkohet transferimi;
 - b) Prokurori duhet të jetë me përvojën më të pakët si prokuror në prokurorinë nga vjen,
 - c) Prokurori duhet të përmbushë kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar

përkohësisht,

2. Transferimi pa pëlqim për një periudhë të caktuar në prokuroritë e apelit do të bëhet së pari nga Prokuroritë e Apelit, sipas kriterëve të këtij neni. Në rast pamundësie, transferimi do të bëhet nga prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë që përmbushin kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.

Neni 13

Identifikimi i prokurorit që do të transferohet pa pëlqim

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës kërkon nga Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesit e Prokurorive informacionin e nevojshëm në zbatim të kësaj procedure.

2. Pas përcaktimit të prokurorisë me ngarkesën më të ulët, duke mbajtur në konsideratë edhe kërkesat e pikës 4, të nenit 5, të kësaj Rregullore, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon në atë prokurori prokurorin me përvojën më të pakët, i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht. Në rastin e disa prokurorëve me ngarkesë më të ulët sipas kësaj pike, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon për secilën nga këto prokurori prokurorin me përvojën më të pakët, i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.

3. Në çdo rast Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson edhe mendimin e Drejtuesit të prokurorisë ku ushtron funksionet prokurori në fjalë.

4. Drejtuesi i prokurorisë dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të prokurorit. Me kërkesë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Drejtuesi i prokurorisë dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të prokurorit. Mendimi i Drejtuesit shpreh vlerësimin e tij mbi ngarkesën e prokurorisë në tërësi dhe të prokurorit në veçanti, numrin total të prokurorëve që ushtrojnë funksionet në atë prokurori, seksionin nga i cili vjen prokurori apo fushën e të drejtës në të cilën ai shërben, pasojat që mund të ketë në ngarkesën e prokurorisë transferimi i prokurorit, si dhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën prokurori mund të transferohet përkohësisht duke mbajtur në konsideratë efektet më të ulëta negative që mund të vijnë nga transferimi. Mendimi i Drejtuesit të prokurorisë nuk është përcaktues.

5. Në përfundim Komisioni përgatit një raport për transferimin pa pëlqim dhe ia paraqet Këshillit për shqyrtim duke i propozuar miratimin e transferimit të përkohshëm dhe periudhën e transferimit.

Neni 14

Vendimmarrja e Këshillit

1. Këshilli merr vendim për të transferuar përkohësisht pa pëlqim prokurorin pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Vendimi i komunikohet menjëherë prokurorit dhe Drejtuesve të Prokurorive ndërmjet të cilave ndodh transferimi.

2. Këshilli mund të vendosë që efektet e vendimit të transferimit të përkohshëm të prokurorit të fillojnë në një kohë më të mëvonshme nga data e vendimit.

KREU IV TE FUNDIT

Neni 15 Përfitimet për shkak të transferimit të përkohshëm

Prokurori i cili transferohet përkohësisht sipas kësaj Rregullore përfiton kompensim sipas parashikimeve të nenit 15/2 të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 16 Regjistri i transferimeve

Këshilli krijon pranë sektorit të Burimeve Njerëzore një regjistër të posaçëm i cili përmban informacion mbi prokurorët e transferuar sipas kësaj Rregullore dhe periudhën e transferimit.

Neni 17 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

